

ALBANIAN GRAMMATICAL TERMINOLOGY OF SAMI FRASHËRI ON HIS BOOK “SHKRONJËTORE E GJUHËSË SHQIP”, BUCHAREST, 1886 TERMINOLOGJIA GRAMATIKORE SHQIPE E SAMI FRASHËRIT NË VEPRËN *SHKRONJËTORE E GJUHËSË SHQIP*, BUKURESHT, 1886

Armand OMERI¹

¹ PhD Candidate in Department of Albanian Language, Faculty of History and Philology, University of Tirana

*Corresponding author e-mail: armandomeri@yahoo.com

Abstract

Sami Frashëri drafted the Albanian grammar in Albanian language and this was a very positive endeavor from the scientific point of view, as well as from national and patriotic standpoint. He worked really hard to explain the language material and simultaneously create and organize the terminology and make it as scientific and as much Albanian as possible for the grammar of his mother tongue. This forced S. Frashëri to really explore on the peculiarities of the Albanian language, so he could produce a grammar (*Shkronjëtores*) as Albanian specific and at the same time stay as far away as possible from foreign grammar influences, despite the findings that Sami Frashëri has been influenced by western languages like German and French. The researchers note that the ideas and theories of S. Frashër have a satisfactory scientific level; if we take into account scientific developments of the descriptive grammar in Western Europe at the time. This paper will highlight terminology and terms as own creations of Sami Frashëri; we will show how many of these terms have found support and have spread into the texts of today's grammar of the Albanian language; will highlight the theoretical concepts of the grammatical categories of the Albanian language, which have stood throughout the time and the scientific truth.

Keywords: *Albanian grammatical terminology, organization of terminology, terms of grammatical categories, definition of concepts and terminological naming conventions.*

Përmbledhje

Sami Frashëri hartoi në gjuhën shqipe gramatikën e gjuhës shqipe dhe kjo qe një ndërmarrje shumë pozitive si nga ana shkencore, ashtu dhe nga pikëpamja patriotike dhe kombëtare. Ai iu përvesh punës që të shpjegonte materialin gjuhësor të gjuhës shqipe dhe njëkohësisht të krijonte e të sistematizonte një terminologji sa më shkencore dhe shqipe për gramatikën e gjuhës amtare. Kjo e detyroi S. Frashërin të hulumtonte mirë në veçantitë e gjuhës shqipe, që të hartonte një gramatikë (*Shkronjëtores*) sa më specifike shqiptare dhe për të qëndruar sa më larg ndikimeve të gramatikave të huaja, pavarësisht konstatimeve se Sami Frashëri ka pasur ndikim nga gjuhët perendimore gjermane dhe frënge. Studiuesit vënë në dukje se mendimet dhe idetë teorike të S. Frashërit kanë nivel shkencor të kënaqshëm, nëse do të mbajmë parasysh zhvillimet shkencore të gramatikës përshkruese në Europën Perëndimore të kohës. Në këtë punim do të veçojmë terminologjinë dhe termat si krijime vetjake të Samiut; do të zbulojmë prejardhjen kuptimore të termave të krijuar nga Samiu; do të tregojmë se sa nga këta terma kanë gjetur përkrahje dhe përhapje në tekstet e gramatikës së sotme të gjuhës shqipe; do të nxjerrim në pah formulimet teorike për kategoritë gramatikore të gjuhës shqipe, të cilat i kanë qëndruar kohës dhe së vërtetës shkencore.

Fjalët kyçe: *Terminologjia gramatikore shqipe, prejardhja kuptimore e termave të krijuar, sistematizimi i terminologjisë, termat për kategoritë gramatikore, përkufizimi i koncepteve, emërtimi terminologjik.*

Sami Frashëri hartoi në gjuhën shqipe gramatikën e gjuhës shqipe dhe kjo qe një ndërmarrje e jashtëzakonshme për kohën. *Shkronjëtorë e gjuhës shqip*, Bukuresht, 1886, rrok në tërësinë e saj përkufizime dhe klasifikime shkencore për gramatikën e gjuhës sonë dhe përbën një pasuri të paçmuar në lëmin e terminologjisë gjuhësore. *Shkronjëtor*-ja hartohet katër vite pas *Grammatikis albanikis glossis* (1882) të Konstandin Kristoforidhit dhe dëshmon për përpjekjet dhe seriozitetin shkencor të S.Frashërit në shkrimin e saj. Në tekstin e *Shkronjëtorë*-s Samiu trajton me anë të metodës përshkruese kategoritë gramatikore; për disa kategori jep përkufizime të karakterit teorik dhe konkretizon me shembuj. Vepra e tij përfshin njohuri dhe një terminologji të pasur shqipe nga disiplinat e fonetikës, të fjalëformimit, morfologjisë, pak nga sintaksa dhe nga shenjat e pikësimit.

Që në krye të librit të Samiut, zbulojmë qëllimin e autorit për të hartuar në gjuhën shqipe gramatikën e gjuhës shqipe; ai e zëvendëson termin “gramatikë” prej greqishtes me albanizmin **shkronjëtorë** dhe jep përkufizimin e vet: *Shkronjëtorë shqip është një dituri më të cilën mësojmë të flasim’ e të shkruajmë mir’ e drejt gjuhën shqip.* (*Shkronjëtorë*..., f. 9). S. Riza pohon se “Samiu i ka bërë një trajtim **organikisht tërësor dhe shkencërisht inovues** strukturës gramatikore të shqipes” (Riza, 2009, f. 424).

FONETIKA. Kjo është një degë e gjuhësisë ku Samiu jep ndihmesën e tij me një varg termash që ai i krijon ose i kalkon prej gjuhëve të huaja. Ai gjen fjalët shqipe më të përshtatshme për t’i emërtuar saktësisht konceptet, shfrytëzon kuptimet e fshehura të fjalëve, i gjallëron këto kuptime dhe krijon një sistem terminologjik me terma shqip. Mjetet tingullore të gjuhës i pagëzon me termat **të përzëshme** (“bashkëtingëlloret”), të cilat “s’fliten dot pa qënë bashkë me të zëshme” (f. 9) dhe **të zëshme** ose **zëtorë** (“zanoret”), të cilat “mund të flitenë vetëm” (f. 9). Veçoritë akustike dhe anatomo-fiziologjike të bashkëtingëlloreve autori i pagëzon me fjalë-terma shqipe, si: (të përzëshme) **të ngurrëta** (termi i sotëm “bashkëtingëllore të zëshme”: *b, d, x, v, g, gj, z, dh* (f. 10); **të çkrifëta** (termi i sotëm “bashkëtingëllore të shurdhëta”: *p, t, c, f, k, q, s, th* (f. 10).

Një nga kuptimet e mbiemrit *ngurrët (i, e)* është: “që i është prerë hovi” dhe ky kuptim i fjalës na bën të mendojmë se termi **të ngurrëta** mund të jetë sinonim me termin “mbylltore” të fonetikës së gjuhës shqipe sot. Një nga kuptimet e mbiemrit *shkrifur (i, e)* është: “3. *fig.* i qartë, i butë (për zërin)” dhe ky kuptim i fjalës na bën të mendojmë se termi **të çkrifëta** mund të jetë sinonim me termin “të buta” të fonetikës së gjuhës shqipe sot. Termat “të zëshme, të shurdhëta” nuk do të qëndronin dot pranë termit samian **të përzëshme**, sepse nuk do të qëndronin as nga ana kuptimore gjuhësore, dhe as nga ana logjike nocionore (**të përzëshme** të zëshme, **të përzëshme** të shurdhëta).

Samiu e thotë në përkufizimin për bashkëtingëlloret se ato nuk shqiptohen dot pa të zëshmet, prandaj krijon termin **të përzëshme**. S. Riza pohon se për termat **të zëshme, të përzëshme** “*autori i Shkronjëtorë-s ia detyron ndikimit të gjermanishtes: Laut; Selbstlaut; Mitlaut*” (Riza, SF, 1, 1964, f. 190). Tek fjalët **të ngurrëta, të çkrifëta**, që Samiu i ka pagëzuar si terma, mendojmë se ka pasur parasysh kuptimet: *të forta* për bashkëtingëlloret e zëshme dhe *të buta* për bashkëtingëlloret e shurdhëta; termat “bashkëtingëllore e butë”, “bashkëtingëllore e fortë” i gjejmë në *FTGJ*, 1975. Për zërat dhe tingujt jo të hollë dhe të ulët themi “zë i trashë, tingull i trashë” dhe anasjelltas “zë i hollë, i lartë, i mprehtë, tingull i hollë etj.”. Për termin **të trasha** që Samiu përdor për bashkëtingëlloret *a, g, k, ll*, (f. 10) dhe që përkon me termin “bashkëtingëllore prapagjuhore”, dhe për termin **të holla** që Samiu përdor për bashkëtingëlloret *e, gj, q, j*, (f. 10) dhe që përkon me termin “bashkëtingëllore mesgjuhore”, mendojmë se Samiu ka pasur parasysh: 1) ngritjen e gjuhës (*a* - e ngritjes së ulët (e hapur); *e* - e ngritjes së mesme (gjysmë e hapur); 2) organin aktiv (gjuhën) dhe 3) vendin e formimit të këtyre tingujve. Në dy grupimet e fundit bien në sy dy zanoret *a, e*, dhe kjo na bën të mendojmë se Samiu ka klasifikuar tingujt në përgjithësi në këto dy grupe.

Nga ana tjetër, përfshirja vetëm e dy zanoreve na bën të mendojmë se do të jetë ndonjë gabim i autorit të *Shkronjëtorë*-s. Termat të **trasha**, të **holla** mendojmë se u përgjigjen termave “prapagjuhore” prkt. “mesgjuhore”. Samiu në këtë pjesë të fonetikës ka bërë një sistematizim terminologjik me terminoelementet e përzgjedhur dhe ka krijuar terma korrelativë me marrëdhënie antonimie apo me kundërvënie binare. Klasifikimi i mëtejshëm i bashkëtingëlloreve të tjera sipas organit aktiv dhe vendit të formimit, si dhe pagëzimi i tyre terminologjik me kalket terminologjike, nuk ndryshon nga klasifikimi i sotëm dhe mund të pohojmë se klasifikimi i Samiut qëndron në bazë të terminologjisë shqipe për disiplinën e fonetikës sot në disa aspekte: **buzëtore** (buzore) (*b, p, v, f, m*); **dhëmbëtore** (dhëmbore) (*c, ç, d, dh, ll, t, th, x, xh*); **fishëllore** (“fishkëllore” quhen bashkëtingëlloret *s, z*, ndërsa *sh, zh* quhen “shushuritëse”) (*s, sh, z, zh*); **grykëtore** (grykore) (*g, k, h*); **qjellëtore** (qjellzore) (*gj, j, l, n, nj, q, r, rr*); siç shihet Samiu përfshin këtu dhe “alveolaret” *n, r, rr* (f. 10).

Procesin fonetik të rënies së një tingulli ose të disa tingujve në fund të fjalës Samiu e pagëzon me termin **shuhet** prkt. “apokopa” në tekstet e fonetikës. Samiu shkruan: “*Shkronja v mund edhe të shuhetë pas të përzëshmevet, si nipërve edhe nipëre*” (f. 41). Gjejmë rastin të bëjmë një vërejtje: nuk shuhet shkronja, por bie tingulli fundor. Duket qartë se Samiu nuk është thelluar në zbulimin dhe analizimin e proceseve fonetike në gjuhën shqipe, pasi termi **shuhet** prkt. “apokopa” është i vetmi që përmendet.

SHKRONJAT. Shkronjat e alfabetit Samiu i përkufizon kështu: “...janë shënjet’ e zëravet që nxjerimë duke folurë, (f. 9). Por ai e përdor termin **shkronjë** dhe me kuptimin e termit “tingull” ose “të përzëshme”, kur shkruan: *shkronjë e shkrifëtë, shkronjë e ngurëtë*, (f. 125). Në veprën tjetër, *Shqipëria ç’ka qenë ç’është e ç’do të bëhetë*, Bukuresht, 1899, Samiu e përcakton qartë konceptin e tij për shkronjën dhe tingullin si dy njësi të dallueshme: “...u bënë shkronjatë shqip të plota e të mbaruara me të pasurë çdo shkronjë një zë edhe për çdo zë një shkronjë më vetëhe) (f. 64).

RROKJA. Samiu ka rrokur dhe disa dukuri të tjera të anës tingullore të gjuhës, si rrokja dhe theksi; për intonacionin nuk gjejmë ndonjë të dhënë. Samiu përkufizon: “*Rrokje thuhetë një a më shumë shkronja q’i rrëmben gjuha e i flet përnjëherë. Fjalëtë janë të bëra prej rrokjeve*” (f. 9). Në përkufizimin e Samiut fjala “shkronja” duhet zëvendësuar me fjalën “tinguj”. Ai dallon në gjuhën shqipe fjalët **njerrokëse, dyrrrokëse, trirrrokëse, shumërrrokëse**. Samiu e përcakton rrokjen vetëm nga këndvështrimi nyjetimor dhe nga ky konceptim mendojmë se ai duhet të jetë mbështetur në informacione mbi *Teorinë e eksploracionit*, që e shpjegon rrokjen si një grup tingujsh që shqiptohen me një të nxjerrë të frymës (Dodi, 2004, f. 128).

THEKSI. Me termin **xgjatës** Samiu pagëzon termin e sotëm “theks”. Ai shkruan: “*Çdo fjalë shqip që ka më shumë se një rrokje zgjatet më njërën nga ato: rërë, érdhi, këtú, páskëshinë* (f. 10). Samiu e pagëzon theksin me termin **xgjatës** dhe prej kësaj kuptojmë se ai mban parasysh njërin nga katër tiparet e theksit në gjuhën tonë: gjatësinë e tingullit, i cili bashkë me intensitetin e tingullit, lartësinë dhe timbrin përbëjnë tiparet e theksit në gjuhën shqipe. Zanorja e theksuar është jo vetëm e fortë, por edhe më e gjatë se zanorja e patheksuar, prandaj në përkufizimin samian ndreqim “një zanore zgjatet” në vend të “një rrokje zgjatet”. Për Samiun termi **xgjatës** ka kuptimin dhe të shenjës grafike mbi zanoren e theksuar (´) *rërë, érdhi* (f. 10).

Në *FSHS*, 1984 gjejmë fjalën: “zgjatës”, 2. *gjuh.* që shërben për të shënuar tingullin që duhet të zgjatet gjatë shqiptimit; *theks zgjatës*. Nga ky shpjegim del se bëhet fjalë për *theksin shkrimor* apo ndryshe *shenjën grafike të theksit* (´) (*FTGJ*, 1975) dhe termi samian vjen deri në ditët tona. “Theksin lakor” që shënohet me shenjën grafike (˘), Samiu e pagëzon me termin **trashje**, që “*vihet përmi ca të zëshme që xgjatenë fort në të folurë*, si: *dhê, pô, sý*” (f. 11). Nga shembujt e Samiut merret vesh se termi përdoret me kuptimin e theksit mbi zanoren e fjalës njërrokëshe. Ja, dhe dy shembuj të përdorimit nga Samiu: **e zëshme e trashë** (për “zanore e theksuar”) (f. 26); **e zëshme e**

xgjaturë (për “rrokjen e theksuar”) (f. 27). Në *FSHS*, 1984 folja *trash* ka kuptimin: 3. *fig. bised. e* forcoj diçka; e teproj në diçka; e bëj më të madh, më të rëndë etj. Mendojmë se Samiu e ka shkëputur këtë kuptim figurativ të foljes *trash*, për të krijuar emrin **trashje** e mandej për ta përdorur me kuptimin terminologjik dhe kështu ka krijuar një term origjinar shqip.

PJESËT E LIGJËRATËS. Samiu përdor termin **farët** me kuptimin e termit “pjesët” dhe **farët e fjalësë** me kuptimin e termit “pjesët e ligjëratës. Ndërkohë që te kapitulli për foljen e përdor termin **farët** dhe me kuptimin e termit “kategori” (gramatikore). Ai shkruan: “*Folja ka nëntë farë ndarjesh: veta, nëmëri, mëndyra, ...*” (f. 83). Termi samian **farët** është i përpiktë, pasi një nga kuptimet e kësaj fjale në shumës është: 7. tërësia e qënieve, e sendeve ose e dukurive që kanë tipare të përbashkëta (*FSHS*, 1984, f. 278). Me termin **fjalët** Samiu ka pasur parasysh fjalën si njësi themelore e gjuhës, si njësi leksiko-gramatikore (*FGGJSLSH*, II, 1976, f. 20); kuptimi i 5-të i njësisë *fjalë* do të thotë “ligjëratë; ... të folurit” (*FShS*, 1984, f. 295).

Mendojmë se termi i gramatikës së gjuhës shqipe sot “pjesët e ligjëratës” është krijuar duke pasur për model termin samian **farët e fjalësë**. Në të njëjtat pozita me konceptin dhe termin samian është dhe arsyetimi i S. Rizës, i cili shkruan se “*farët e fjalëveve ose pjesët e ligjëratës janë jo pjesët e fjalisë prkt. gjymtyrët e periudhës, por përkundrazi farët e fjalëveve. (...) ...pjesët e ligjëratës alias farët e fjalëveve të qëndrueshmoheshin dhe të përkufizoheshin nga pozitat jo të mortofologjisë, por të leksikologjisë.*” (Riza, 2009, f. 448). Samiu dallon te **farët e fjalësë** (pjesët e ligjëratës) dhjetë farë fjalësh: emëratë, nyjetë, miemëratë (mbiemrat), përemëratë, foljetë, pjesëtoretë (pjesoret), mifoljetë (ndajfoljet), parjetë (parafjalët), lidhjetë (lidhëzat), thirrjetë (pasthirmat). Nuk klasifikon sipas gramatikës së gjuhës shqipe sot pjesëzat, numërorët, ndërsa përfshin nyjet, pjesoret si farë (pjesë) të mëvetësishme të ligjëratës.

Në bazë të veçorive morfologjike **farët e fjalësë** (pjesët e ligjëratës) Samiu i ndan në: **të përkthyer** (të ndryshueshme, të eptueshme); sipas Samiut d.m.th. “....që përndryshohen: emëratë, nyjetë, miemëratë, përemëratë, foljetë” (f. 11); **të papërkthyer** (të pandryshueshme, të paeptueshme); sipas Samiut d.m.th. “....që s’ndryshohenë kurrë: përparjetë, lidhjetë, thirrjetë, pasfoljet” (fq. 11). Termat **të përkthyer**, **të papërkthyer** janë sinonimë me termat e sotëm prkt. “të eptueshme, të paeptueshme” dhe kanë të përbashkët bërthamën kuptimore të mundësisë së ndryshimit të formës së fjalës [“përkul, lakoj” (sendet)], prkt. të pamundësisë së ndryshimit të formës së fjalës. Termi **të përkthyer** (f. 21) është term sinonim me termin e gramatikës së gjuhës shqipe sot “eptimi”.

STRUKTURA MORFOLOGJIKE E FJALËS. Në strukturën morfologjike të fjalës Samiu dallon këto pjesë: **rënjë, shtonjë, mbaronjëtorja, fundje** dhe jep këto përkufizime: “**rënjë** i thonë copës’ së foljesë q’është e vetijtë edhe s’ndrohetë. Në foljetë shkruarë, shkruanj, shkrova, shkruhetë, copa shkr është rrënja, edhe copatë uarë, uanj, ova, uhetë janë shtonja (f. 85); “**shtonjë** i thonë copësë që shtohetë për të treguar motnë, mëndyrënë, vetënë, nëmurinë; në foljetë shkruarë, shkruanj, shkrova, shkruhetë, copa shkr është rrënja, edhe copatë uarë, uanj, ova, uhetë janë shtonja (f. 85). Samiu përdor dy terma për të njëjtën pjesë të strukturës së fjalës: **mbaronjëtorja** dhe **fundje** (f. 33).

Në fjalorin që shoqëron *Shkonjëtorë*-n, dy termat përdoren me kuptimin “fundore e fjalës”, sipas A.Dodit. Po t’i kthehemi *FSHS*, 1984, do të gjejmë fjalën “shtojë” me kuptimin “shtim”, e cila është ngritur në term nga Samiu dhe përkufizohet “*pjesë fundore e fjalës*”, nga fr. “*terminaison*” (*Fjalëtë e Shkonjëtoresë -terminologjia e gramatikës*) (f. 172-175). Po t’i rikthehemi përkufizimit të Samiut për **rënjë** dhe **shtonjë**, kuptohet se termi samian **shtonjë** i referohet termit “mbaresë” të gramatikës së gjuhës shqipe sot. Mendojmë se termi **shtonjë** nuk mbulon plotësisht konceptin “mbaresë”; **shtonjë** është më pranë konceptit “ndajshitesë”.

Termat samianë **mbaronjëtorja** dhe **fundje** janë termat që saktësisht mbulojnë konceptin e pjesës fundore të fjalës, të asaj pjese që ndryshon gjatë lakimit të emrave dhe zgjedhimit të foljeve. S. Riza pranon termin samian “fundje”. Fjala e ligjërimit bisedor “fundje” ka kuptimin “mbarim, fund; përfundim” (FSHS, 1984, f. 319). Në një përshkrim për fjalëformimin, Samiu e koncepton termin **fundje** si prapashtesë: “*Emëravet u viret nga një herë fundje për të treguarë një gjë të vogëlë a të përkëdhelurë: th, zë* (f. 44). b) *Nga pasfolje kohe a vëndi me të marrë nyjetë në kryet edhe fundjenë shm, shim, a m si: tani, i tanishëm a i tanishim; nesër, i nesërm; sot, i sotm* (f. 57). Ndërsa në një tjetër përshkrim për trajtëformimin Samiu e koncepton termin **fundje** si mbaresë: *fundore ja: nuseja, nusja, Sulçeja, Sulcja; fundore ua: Markoja dhe Markua* (f. 33). Autori i *Shkronjëtores*-s pagëzon dy koncepte të ndryshme me të njëjtën fjalë-term dhe për këtë arsye nuk biem në një mendje me autorin.

FJALËFORMIMI. Në fushën e teorisë së fjalëformimit kontributi i Samiut është modest, por termat e tij janë albanizma origjinare, ashtu siç është i tërë fjalori terminologjik i krijuar dhe i pagëzuar prej gjuhëtarit shkencëtar dhe patriot. Te **fjalët** dhe prejardhja e tyre Samiu shquan dhe pagëzon me termat vetjakë: **fjalë më vetëhe**: *i djathtë, i mëngjërë, i huaj* (f. 57); **fjalët e ngjitura** (f. 58). Tek termi **fjalë më vetëhe** terminoelementi *më vetëhe* ka të njëjtin kuptim me fjalën e vjetër *mëvetësi*, dhe sot në tekstin e morfologjisë gjejmë termin samian për tipin e fjalëve në bazë të kriterit sintaksor: **pjesët e ligjëratis** ndahen në *fjalë të mëvetësishme*: emri, folja, mbiemri, numërori, përemri, ndajfolja, pasthirrma (FGGJSLSH, II, 1976, f. 18). Me termin vetjak **fjalët e ngjitura** Samiu ka pasur parasysh fjalët e përbëra, ndërsa sot ky togfjalësh terminologjik është pjesë e fjalorit të termave të gjuhësisë, veçse shënon një tjetër koncept, “fjalët e përngjitura”.

Termi samian **fjalët e ngjitura** i ka paraprirë termit të sotëm “fjalët e përngjitura” me terminologjizimin e fjalës-mbiemër **e ngjitur** si terminoelement. Samiu nuk përdor në këtë pjesë të *Shkronjëtores*-s së tij për fjalëformimin termin “formim”, i cili është i burimit të huaj, por pagëzon si term emrin asnjansës prejpjesor **të bërët**: *të bërët e miemëravet* (f. 57). Për termin **fundje** me kuptimin e termit “prapashtesë” folëm më lart. Samiu vëren dhe shkruan se “*nga emërat’ e xvogëluara janë ca që tregojnë një gjë tjetërë e jo atë që tregon emëri, të xvogëluarë, si: njerith, qengjzë*” (f. 44).

Në këto arsyetime gjejmë përpjekjet e para në fushën e semantikës dhe të leksikologjisë, përpjekje për të shpjeguar jo vetëm mënyrën e fjalëformimit, por edhe kuptimet e reja që fiton fjala shqipe. Fjala **fjalëtorja** (f. 19) është një fjalëkrijim dhe emërtim në leksikologji, me të cilin Samiu pagëzon “fjalorin”, librin me fjalët e një gjuhe. **Fjalëtore** për nga ndërtimi është në pajtim me rregullat dhe ligjet e fjalëformimit në gjuhën shqipe, analoge me *ëmbëllore, gjelllore* etj., që i gjejmë në përdorim edhe sot.

MORFOLOGJIA zë rreth 160 faqe të *Shkronjëtores*-s dhe është disiplina që Samiu i kushton më shumë vëmendje.

EMRI. Samiu shkruan: “*Emërë quhetë një fjalë që rrëfen një njeri, një shtëzë a një gjë të lëntë a të palëntë si: njeri, qen, gur, frikë* (f. 13) (nënvizimet me bold - A.O.). Samiu përcakton me saktësinë e një shkencëtari serioz se “*Edhe emëratë që rrëfejnë kohë përdorenë si mifolje kohe në rënjet kallzonjëtores, si: ditënë, natënë. Edhe shumë emëra bashkë me një parje përdorenë si mifolje kohe: për herë, në mëngjest, më të nesërmet* (f. 168). Nga pikëpamja kuptimore, përkufizimi i Samiut është i ngjashëm me përkufizimin për emrin që japin gramatikët sot, por dallon me mospërfshirjen e emrave që emërtojnë dukuri të natyrës, emra cilësie, emra veprimi, të cilët në përkufizimin e autorit të *Shkronjëtores*-s mungojnë. Në grupet leksiko-gramatikore të emrave Samiu dallon **emër i përgjithçim** (*gur, dru, ve*); **emër i përveççim** (*Gjergj, Rrapo, Devoll, Qarr*) (f. 13); **emërat e xvogëluara**: “*emëravet u viret nga një herë fundje për të treguarë një gjë të vogëlë a të përkëdhelurë: th, zë*” (f. 44).

Disa grupe emrash Samiu i klasifikon me një terminologji komplekse, shprehur me një strukturë fjali të përbërë e ku pjesa kryesore e këtij konstrukti është një fjali e paplotë: **emëratë që rrëfejnë një gjë të pandarë** (emrat e lëndës) *ujë, gjalpë, mish, grurë, vaj, dyllë* (f. 15); **emëratë që rrëfejnë një punë të palënttë** (emrat abstraktë) *të mirëtë* (mirësia), *të likë* (ligësia) (f. 15); **emëratë që rrëfejnë një bërje** (emra veprimi) (15); **emëratë që rrëfejnë fis** (emra farefisnie) (f. 69).

GJINIA. Klasifikimin e emrave në gjini Samiu e pagëzon me një konstrukt terminologjik të zakonit në strukturën e gjuhën shqipe, por të pazakontë nga pikëpamja kuptimore në gjuhën shqipe: emër + emër në funksion ndajshimor: **emëratë meshkuj** (emrat mashkullorë), **emëratë femëra** (emrat femërorë) (f. 40). Kategorinë gramatikore të gjinisë Samiu e pagëzon me termin **gjindje** dhe tek emri dallon **gjindjen mashkullë, femërë, asjatërë** (f. 14). E gjejmë me vend termin samian të shekullit XIX **gjindje** për gjininë, po që se shikojmë lidhjen kuptimore të kësaj fjale me familjen e saj në *FSHS*, 1984, f. 386: **gjind** - njerëzit e shtëpisë; **gjindje** - tërësi njerëzish; **gjini** - grup njerëzish me lidhje gjaku; tërësi e tipareve natyrore që dallojnë mashkullin nga femra; **gjini** - term në gjuhësi: kategori leksiko-gramatikore në një varg gjuhësh.

Për “gjininë asnjansë” si gjini, e cila nuk është as mashkullore, as femërore, Samiu ka pagëzuar si term përemrin e pacaktuar **asjatërë**, i cili do të jetë përdorur me kuptimin “as njëri, as tjetri; as me njërin, as me tjetrin”. Si përemra të pacaktuar të trashëguar nga një fazë e hershme në fazën e dokumentuar të shqipes shërbejnë *jetër/jatër* (sot *tjetër/tjatër*) (Demiraj, 1986, f. 514).

NUMRI. Samiu njeh dhe përcakton saktë kategorinë gramatikore të numrit të emrave: **njëjësi** “*që rrëfen një gjë të vetëmë*” (f. 16); **shumësi** “*që rrëfen më tepërë*” (A.O - gjëra) (f. 16). Shumësin e disa emra, i cili formohet me ndryshime të tingujve brenda temës së fjalës e që shoqërohet nganjëherë dhe me prapashtesa, Samiu e ka pagëzuar me termin **shumësi i parregullt** (*njeri, njerëz; djalë, djem; kalë, kuaj; grua, gra;*) (f. 19).

SHQUARSIA. Kategorinë e shquarsisë prkt. të pashquarsisë Samiu e pagëzon me termin **çqimi** (shquarsia) (f. 39), prkt. **paçqimi** (pashquarsia) (f. 39); **i çquar** (i shquar) (f. 42), **i paçquarë** (i pashquar) (f. 41) dhe kategorizon në klasën e emrave **emërat e çquarë** (f. 41), **emërat e paçquarë** (f. 41) ashtu si në gjuhët e tjera. Fjalën e vjetër *shqim* (= **çqim** në drejtshkrimin samian), sinonime dhe të afërt për nga kuptimi me fjalën “*dallim*”, Samiu e ka pagëzuar term në gjuhësi dhe kundërvënien formale trajtë e shquar / trajtë e pashquar e ka pagëzuar me kundërvënien terminologjike **çqimi / paçqimi**. Termi samian **paçqimi** është element i sistemit terminologjik që shënon një koncept të caktuar, por në gjuhën shqipe formimi i një emri me parashtesë *pa-* + emër veprimi më *-im* është tepër i rrallë. Në *FSHS*, 1984 gjenden vetëm dy fjalë më këtë strukturë fjalëformuese: padurim-i, pambarim-i.

Termin **formë** Samiu e përdor në kuptimin e termit të sotëm “trajtë” në togfjalëshat terminologjike **forma e çquarë** (trajta e shquar), **forma e paçquarë** (trajta e pashquar) (f. 21). Shenja (fjala) e mbulon nocionin. “Trajtë” dhe “formë” janë dy fjalë sinonime, që përputhen në pjesën më të madhe të kuptimeve të tyre sipas *FSHS*, 1984, madje dhe si terma në gjuhësi; prandaj mendojmë se denduria e përdorimit të njërit term në raport me termin tjetër, i jep përparësi dhe mundësi normëzimit terminologjik; përdorimi do të përcaktojë normën terminologjike.

RASA. Samiu ka kalkuar nga gjermanishtja termin *Fall* dhe nga greqishtja termin *ptōsis* (πτῶσις) me fjalën shqipe **rënie** ose **rënja** (në trajtë të shquar, f. 21) për termin e sotëm “rasë”. Dhe në gjuhën ruse gjejmë fjalën *падѣние* (padjenie) me kuptimin “rënie” për termin “rasë”. Në numrin shumë Samiu shkruan **rënietë**. Sipas A. Xhuvanit në shkrimin “*Fjalë e fraza shqipe me shtrembërim trajte a kuptimi a ndërtimi*, Vepra I”, termi i sotëm “rasë” është “*kalkim nga cadere “me ra, të rënë”*; u përdor si term gramatikor në veprat e autorëve të veriut, kurse Samiu përdor termin “*rënia*”. Në shtypin e veriut fjala “rasë” u përdor dhe me kuptimin *cas, caso, occasione* në

shprehjet “më ra rasa, gjeti rasën”, kurse në jug u përdor trajta rasti: “erdhi rasti, ka raste” (Xhuvani, 180, f. 179). Termin “rasë” e gjejmë në fjalorët angl. *case*, fr. *cas*, gjerm. *Kasus*; *Fall*, it. *caso*. Samiu përkthen nga gjuhët evropiane dhe numëron gjashtë **rëni**të në gjuhën shqipe: **quanjës**torja (emërore), **pjellës**torja (gjindore), **dhënës**torja (dhanore), **kallëzonjës**torja (kallëzore), **pritës**torja (vendore), **mërgonjës**torja (rrjedhore). Rasën “emërore” Samiu e pagëzon me termin **quanjës**torja nga folja “quaj”, e cila është fjalë sinonime me foljen “emërtoj”, e prejardhur nga fjala “emër” e nga kjo e fundit u krijua mbiemri i panyjshëm prapashtesor “emërore” dhe më tej me anë të substantivimit kemi termin “emërore” për rasën e parë të gjuhës shqipe e të shumë gjuhëve evropiane.

Samiu krijon fjalë-terma mbiemërore prej temash emërore, foljore dhe me tema pjesore plus prapashtesën *-tor(e)* e prej tyre me anë të emërzimit krijon termat mbiemra të emëruar **pritës**torë ~ **pritës**torja, **quanjës**torë ~ **quanjës**torja, **pjellës**torë ~ **pjellës**torja e kështu, me këtë mënyrë fjalëformimi, pagëzon me terma dhe ratat e gjuhës shqipe. Për rasën “gjindore” Samiu përkthen gjerm. *Genitali*, angl. *genital* për të dhënë termin **pjellës**torja. Në *FISH*, 1939 gjejmë fjalën *genitale* mb. “pjellësuer, që pjell, gjinuer”; *genitive*, a, mb. “gjinuer; em. rasa gjindore”. Dhe në *RHD*, 1978, fjala “genitive”, *Gram. -adj.* në kuptimin e parë do të thotë shënimi i një rase që shpreh zotërim ose origjinë, si në latinisht; kuptimi i dytë është *-n*. (emër), rasa genitive (gjindore). Duket që për Samiun termi **pjellës**torja është i duhuri, është dhe fjalë shqipe që ai e pagëzon si term për të shënuar “rasën gjindore, gjindore”.

Dhënëstorja nuk ka dallim kuptimor nga termi i huaj it. *dativo*, angl. *dative*, rus. *datelnëj* (A.O. - me alfabet latin), gjerm. *Dativ*, fr. *datif*, gr. *dhotikí*. Termi samian, që përkton nga kuptimi, por ndryshon nga forma (shenja, fjala) me termin e sotëm “dhanore”, mban kuptimin “e dhënë, e dhuruar”. Këtë kuptim ka fjala it. *dato*, a, mb. i dhânun, i dhuruem; em. dhuratë (*FISH*, 1939). Nga mbiemri i *dhënë* mendojmë se vjen termi samian **dhënës**torë. Sipas S.Rizës, “që nga *Buzuku e tëhu*,.... kuptimi themelor i dhanores është përkundrazi ai i një ndajardhjeje dmth. i një avitjeje ndaj... (Riza, 2009, f. 274). **Kallëzonjës**torja (rasa kallëzore) është term dukshëm i kalkuar nga termi i gjuhëve evropiane dhe termin për rasën kallëzore këto gjuhë e kanë marrë nga latinishtja *casus accusatives*, që është një përkthim i gabuar i greqishtes *aitiatiké ptosis* “rasa e objektit”, e cila i referohet atij që pëson një veprim të prodhuar nga një “shkak” (*aitia*) (Robins, 2007, f. 70). Në italishten e sotme kemi *accusare*, fv. “me paditë”; *accusa*, ef. “ankim, kallzim” (*FISH*, 1939).

Mërgonjëstorja është termi samian për “rasën rrjedhore”, që përdorin sot gjuhëtarët. Fjala gr. *áferetiki* ka edhe kuptimin e shkakut dhe Samiu do ta ketë pasur parasysh këtë kuptim për të pagëzuar termin **mërgonjës**torja. Sipas S.Rizës, “që nga *Buzuku e tëhu*, kuptimi themelor i rrjedhore është ai i një prejardhjeje dmth. i një largimi prej ..., (Riza, 2009, f. 274). “Rrjedhorja ka si kuptim themelor atë të prejardhjes, siedhe kuptimet analoge të shkëputjes, shmangies, shkakut, lëndës përbërëse” (Riza, 2009, f.313).

Nga termi **mërgonjës**torë del se Samiu do të ketë pasur parasysh një nga kuptimet e rasës rrjedhore, e pikërisht, kuptimin e largimit apo të shmangies. Sipas Sami Frashërit, emri në rasën rrjedhore është gjithnjë i pashquar, konstatim, të cilin e ripohon dhe e argumenton S. Riza. **Pritës**torja është termi i Samiut për “rasën vendore”, term i cili në gjuhët evropiane u kalkua nga latinishtja. Kështu dhe termat rus. *mestnëj*, fr. *locatif*, angl. *locative*, gjerm. *lokativ*, it. *locativo* lidhen kuptimisht me vendin. Termi samian **pritës**torja për “rasën vendore” mendojmë se lidhet me fjalën *prit/ë,~a*, f. leddh prej dheu..., vend... (*FSSH*, 1984).

LAKIMI. Samiu emrat e shqipes i ka ndarë në 16 “përkthesa”. Kështu i ka quajtur ai lakimet. Samiu i klasifikoi emrat në *lakimin e emrave mbi bazën e numrit njëjës* dhe në *lakimin e emrave mbi bazën e numrit shumës*, të cilin S. Riza e quajti klasifikim dualist të Samiut (Riza, 2009, f. 324). Gramatografia evropiane njeh vetëm lakimin e emrave mbi bazën e numrit njëjës.

Në fjalorin terminologjik të *Shkronjëtorë*-s, hartuar nga Samiu, “lakimi” pagëzohet me termin **përkthesë** (lakimi, f. 21), **përkthesat** (lakimet), dhe prej këtyre vijnë termat **përkthej** (lako), **të përkthyerët** (të lakuarët). Samiu shkruan për 16 **përkthesa** (déclinaison des noms, klisis ónomáton, lakim). Në të gjithë fjalorët dygjuhësh shqip - gjuhë e huaj, me të cilët po konsultohemi në këtë artikull, gjenden fjalët-terma që kuptimisht janë të njëjtë me fjalën-term në gjuhën shqipe **përkthesë**, të cilën Samiu e pagëzon term në morfologji. Fjala *kthesë* është sinonime me fjalët *bëryl* (rruge, lumi), *dredhë*, *lakesë*, *lakim*, *gjarpërim*, *hark*, *lak*, *lakore* ... (FSGJSH, 2007).

Gati të gjithë termat nga gjuhët e huaja për “lakimin” kanë ngjashmëri në një nga kuptimet e fjalës, tema e së cilës ka shërbyer për pagëzimin e termit: rus. *skllonenie* (lakim), *skllon-jat* (ul, përkul, gram. lako); gjerm. *Ab-Wandlung* (lakim), *abwandein* (ndryshoj, lako, zgjedhoj), *wandlung* (ndryshim, shndërrim) bashkë me parashtesën e ndashme foljore **ab** tregon lëvizje, ndryshim nga lart poshtë; it. *declinazione* (rënie, gram. lakim), *declino* (pjerrësi, rënie); angl. *declension* (gjuh. i lakueshëm), *decline* (pjerrësi, rënie, pjerrje). Për termin e sotëm “lakimi” me anë të parashtesimit Samiu krijon fjalën-term **përkthesë**, që sot përdoret si term edhe në letërsi, edhe në muzikë, sinonim me termin “refren” (FGJSSH, 1980).

NYJA. Me termin **nyjetë** ose **nyji** (autori e përdor këtë term në gjininë femërore ose në gjininë mashkullore) Samiu kishte parasysh “nyjat shquese” prkt. “nyjat e prapme” të gjinisë së emrave dhe i pagëzon **nyjet në funt**; “*nyjet në funt: mashkulli i, femëra e, asjatëri të*” (f. 39). “*Këto ngjitenë në funt t’emërave, se ata s’janë fjalë më vetëhe, edhe u muar vesh nga sa thamë në të bërë të rënjevet’*. (...) *Nyjetë ndahen më tre: mashkullë, femërë edhe asjatërë; ... edhe të gjithë kanë rënjetë si edhe emëri* (f. 45); **nyjetë mashkullë, nyjetë femërë, nyjetë asjatërë** (të ngrënë, të vajturë, të ardhurë, të mirë, të ligë). **Nyjet në fund** janë “nyjat e prapme” prkt. “nyjat shquese” në gramatikën e gjuhës shqipe sot (FGGJSLSH, II, 1976, f. 120).

Samiu dallon ndërkohë “mbaresat rasore” nga “nyjat e përparme” të emrave, të mbiemrave, të përemrave, edhe pse i emërton me të njëjtin term. Samiu “nyjat e përparme” dhe “nyjat shquese a të prapme” i përkufizon kështu: “**Nyjetë** janë ca fjalë të vogëla që ryjnë nëpër emërat, mbiemërat dhe përemërat për të lidhur’ ato a për të çquarë. Në klasifikimin e “nyjave” Samiu dallon **nyjetë të lidhurë** “do-me-thënë që përdorenë bashkë me një fjalë përparë tyre: gur **i** malit, i gurit **të** malit, gurr’ **e** malit; balt’ **e** fushësë, baltës’ **së** fushës, baltn’ **e** fushës” (f. 45). “Për të qenë nyja e lidhurë, duhetë q’emëri që vjen përpara saj të jetë i çquarë: djalën’ **e** ri, vashën’ **e** re” (f. 48). Samiu i quan **nyjetë të lidhura** ngaqë ndryshimi i tyre është i lidhur me ndryshimin në gjini, në numër dhe në rasë të fjalëve, të cilave u përkasin; me pak fjalë: “janë të lidhura” apo të varura nga ndryshimet që pëson fjala gjatë lakimit.

Samiu klasifikon në grupin e dytë të “nyjave të përparme” **nyjetë të çkëputurë** “do-me-thënë që s’kanë fjalë përpara: **i** malit, **të** malit, **të, së** malit; **i** lartë, **të** lartit, **të, së** larti” (f. 45). “Për të qenë nyja e çkëputurë, duhetë q’emëri që vjen përpara saj të jetë i paçquarë: një djalë **të** ri, një vashë **të** re” (f. 48). Këto nyja Samiu i merr si të pandryshueshme, të palakueshme gjatë përdorimit në fjali, sepse ato nuk ndryshojnë kur para tyre është një emër në trajtë të pashquar: një djalë **të** ri, një vashë **të** re” (f. 48). Por ky klasifikim nuk na duket shumë bindës, pasi bëhet fjalë për të njëjtat nyja: për “nyjat e përparme të mbiemrave” dhe “nyjën e rasës gjinore”, por që ndodhen në marrëdhënie sintaksore emër i pashquar + mbiemër (+ emër ose + pjesë e ligjërates e emërzuar në gjinore); emër i shquar + mbiemër (+emër ose +pjesë e ligjërates e emërzuar në gjinore).

MBIEMRI. *Miemëratë* thuhetë një fjalë që tregon çfarjen’ dhe qyshjen’ e një emëri: njeri i mirë, shtëpi e lartë, burrë trim (f. 49). Përkufizimi i Samiut nuk ndryshon asfare nga përkufizimi që gjejmë në gramatikën e gjuhës shqipe sot dhe po e citojmë duke ndërfutur termat e Samiut: “Mbiemër (*miemëratë*) quhet (*thuhetë*) ajo pjesë e ligjërates (*një fjalë*) që emërton (*tregon*) një tipar (*çfarjen dhe qyshjen*) të sendit (*e një emri*).

Samiu bën dhe klasifikimin morfologjik që nuk ndryshon nga klasifikimi sot: **miemëratë të nyejshime** ose **të nyjshim** “do-me-thënë ato që përdorenë të ngjitura me nyjetë: i mirë, i ligë”; **miemëratë të panyejshime** ose **të panyjshim** “do-me-thënë ato që përdoren pa nyje: përtac, trim, lakuriq” (f. 49). Për nga formimi i mbiemrave Samiu dallon **miemërat’ e ngjitura** (mbiemrat e përbërë), ata që sot i quajmë mbiemra kompozitë e që “...janë të bëra prej një emëri dhe një miemëri a prej dy emërash. Këta s’ marrinë kurrë nyje: sy-zi, sy-zezë; faqe-kuq, faqe-kuqe; jetë-math, ditë-gjatë; zemërë-gur, hundë-dash, sy-hirë” (f. 58).

NUMËRORI. Numërorin Samiu e përfshin në klasën e mbiemrave dhe i quan **miemëra nëmuri** që janë fjalë që tregojnë nëmurin’ e emërave. Këto ndahen më dy; të thjeshtë dhe të rrjeshtme (f. 59). Përkufizimi i Samiut është gati i njëjtë me përkufizimin që morfologjia sot jep për numërorin, vetëm se Samiu nuk njeh termin “numëror” për këtë klasë fjalësh. **Miemra nëmuri të thjeshtë** (A.O. - numërorë themelorë) janë fjalë që tregojnë vetëm numërin’ e emërit, këto janë: një, dy, tre (tri), katërë, pesë, njëzet, tridhetë, njëqint, një mijë, një miliun etj. (f. 59). Edhe pse sipas traditës numërorët rreshtorë janë mbajtur si numërorë, Samiu i klasifikon ata si mbiemra dhe po kështu i trajton dhe gramatika sot. **Miemra nëmuri të rrjeshtme** (A.O. - numërorë rreshtorë) bëhenë prej të thjeshtmeve (A.O. - prej mbiemrave nëmuri të thjeshtë) me të marrë fundjenë të edhe nyjetë, edhe përdorenë si të gjithë miemëratë, ...: i parë, i dytë, i gjashtë a i gjashtë, i shtatëtë a i shtatëtë ... këta përkthehen’ edhe përdorenë si të gjithë miemëratë... (f. 61).

PËREMËRI. ...“thuhet fjalët që s’ tregojnë një gjë më vetëhe, po përdorenë në vëndit t’emërit a të miemërit. Përemëri ndahet më gjashtë farë: **vetëtor**, **gjëtrejonjës**, **dëftonjës**, **përmëndës**, **pyetës**, **ndamës** (f. 63). Në përkufizimin e Samiut theksohet të treguarit, si funksioni kryesor i përemrit dhe përdorimi i tij në vend të emrit a të mbiemrit. **Përemëri vetëtor:** “përemri vetëtor ka tri veta (f. 64). Fjala “vetë” ka kuptimin “njeri, frymë, rob” (FSGJSH, 2007) dhe përputhet me termat e gjuhëve evropiane për këtë lloj të përemrit: fr. *personel*, angl. *personal*, it. *personale*. Me këtë përputhje kuptimore ky term ka zënë vend në gramatikat e mëvonshme.

Përemëri gjëtrejonjës: “janë atë që rrëfejnë e kujt është një gjë; i kanë nga dy, një nënë duke vështuarë gjënë; edhe tjetrënë duke vështuarë të zotn’ e gjësë (f. 66). “Duke kalkuar terminin gjerman *besitzanzeigend* = pronëtragues, autori përemrat pronorë i ka pagëzuar “përemra gjëtrejonjës”... (Riza, 2009, f. 714). Fjala “gjë, gjëja” përdoret me disa kuptime dhe disa prej tyre janë “pasuri, mall, pronë”. Pikërisht këto kuptime të fjalës “gjë, gjëja” mendojmë se ka shfrytëzuar Samiu për të pagëzuar termin kompozitë **gjëtrejonjës**. **Përemëri dëftonjës:** “thuhet ata që dëftejnë një njeri a një gjë t’afërt’ a të largët” (f. 75) dhe ky përkufizim gjendet si i tillë në gramatikat e sotme shqipe. Termi i Samiut është kalkim i përpiktë nga termi për përemrin dëftor që gjendet në gjuhët evropiane dhe në rrusishtë.

Përemëri përmëndës: (lidhor) “janë ata që përdorenë në vëndit të një emëri të zënë ngoje më sipër: a) përemëri që, i cili është i pandërruarë edhe përdoretë kështu në gjithë gjindjet, në gjithë nëmurat e në gjithë rëniet, si: ay që, ajo që, ata që etj.; b) fjala **cilë** që përdoret me nyjetë edhe përkthehetë në gjithë gjindjet, nëmurat e rënjet si gjithë mbiemërat’ e mbaruarë më ë, si: i cili, të cilit etj.; c) përemërat pyetës **kush, çë, se, sa**, kur s’ tregojnë pyetje, zihenë përmëndës” (f. 76). Kuptimi apo përkufizimi i Samiut për **përemërin përmëndës** mendojmë se është sinonim me kuptimin e “përemrit vetor”; dhe përemri vetor përdoret në vend të një emri të zënë në gojë, të përmendur më parë. Po hedhim një pandehmë: mundet që termin **përemër përmëndës** Samiu ta ketë formuluar duke kalkuar termin gjerman “*bezügliches Fürwort*”. Fjala “*Bezüge*” do të thotë “referim”; dhe më tej, fjala “referohem” ka sinonime kuptimet “përmend, ka lidhje me”. Gjithashtu dhe fjala greke *anaforikí* në një nga kuptimet e saj do të thotë “përmendje”. Këtu mendojmë se gjendet burimi i termit samian dhe më pas burimi i termit të A. Xhuvanit “përemër lidhor”, por

mendojmë se termi i A. Xhuvanit është më pranë kalkimit prej gjuhëve riolatine (A.O. - fjalën “riolatine” e huazuam nga S. Riza).

Përemëri pyetës: “janë ata me të cilët pyetetë një njeri a një gjë a qysh e sa është një gjë”. Këta përemra përkufizohen me saktësi prej Samiut, po ashtu dhe funksionet e secilit prej tyre: a) **kush**, me të cilën pyetetë veta, njeriu; b) **çë a ç’**, me të cilën pyetetë gjëja a edhe veta; ky është i papërkthyerë: *ç’ njeri, ç’ punë*; c) **se** në kallzonjëtoe e në pritëtoet, **seje** në mërgonjëtoe; ç) **cilë** me të pyetetë kush nga dy a nga shumë njerëssh a gjërërash: **cili, cila**; d) **sa** me të cilën pyetet nëmuri a shumicë e njerësve a e gjërërave: **sa, (i) save, sash**. (f. 77).

Përemëri ndamës: *jan’ ata që ndajnë gjëratë duke treguarë qysh e sa janë*. Këta ndahenë më dy: *ata që tregojnë sa, edhe ata që tregojnë qysh* (f. 78). Në gramatikat e sotme ky grup përemrash emërtohet “përemra të pacaktuar” ose “përemra të pakufishëm”. Në ngjizjen e termit **përemra ndamës** Samiu nuk përdor kalkun “kufi”, e cila si fjalë në gjuhën shqipe ka përdorim të rëndomtë, por përpiket të pagëzojë si term një nga kuptimet e kësaj fjale. Një nga kuptimet e fjalës “kufi” është “vijë ndarëse” dhe një nga kuptimet e fjalës “kufizues” është “ndarës” e më tej **përemra ndamës**.

Kurse termi që përdor gramatika shqipe sot është ndërtuar me formën mohore të terminoelementit “përemra të pacaktuar” ose “përemra të pakufishëm” dhe është më pranë kalkut të termit nga gjuhët riolatine apo nga gr. “*aoristos*”. Në qoftë se do të nisemi nga përputhja e kuptimit të termit **përemëri ndamës** me ndarjen në dy grupe që Samiu bën për këta përemra: në përemra që tregojnë *qysh* dhe në përemra që tregojnë *sa*, atëherë mund të hamendësojmë se terminoelementi samian **ndamës** pagëzon këtë ndarje apo këtë klasifikim në grupe të përemrit.

Mund të hamendësojmë gjithashtu se Samiu në përcaktimin e termit do të ketë mbajtur parasysh kuptimin e përemrave: në përemra që tregojnë frymorë apo sende (por nuk i cilëson si të pacaktuar) dhe në përemra që tregojnë sasi frymorësh a sendesh (por nuk i cilëson si të pacaktuar). Samiu nuk e ka shprehur kuptimin mohues të terminoelementit dhe kjo e vështirëson zbulimin e origjinës së termit, e vështirëson zbulimin e kuptimit të fjalës që Samiu e gjallëron dhe e pagëzon si term: **ndamës** sepse ndajnë gjërat në *qysh* dhe *sa* apo **ndamës** si *kufi, vijë ndarëse*. Po japim më poshtë të dhënat për këta përemra sipas studimit të Samiut:

Përemëratë ndamës që tregojnë **qysh** janë: a) **tillë** e cila përdoret me nyje: *i tillë, e tillë, të tillë, të tilla*. Ky përemërë merr edhe një *a* në krye për të treguarë së largu, a një *kë* për të treguar s’afëri: *i atillë, e atillë, i këtillë, e këtillë*; b) përemërat **kush, cili** të pjekura me *akë, si, di* në kryet, a *do* në funtt, a *si* në kryet e *do* në funtt: *akëcili, akëkush, sikush, dikush, dicili, kushdo, cilido*; c) përemëri **kush** i pjekurë me fjalët *kurrë, gjithë: kurrëkush, gjithëkush*; ç) përemëri **ç** i pjekurë me fjalët *do: çëdo a ç’do*; d) përemëri **akë**, i cili përdoret si miemërë dhe është i papërkthyerë. Shumë herë merr edhe miemërinë *ç’ pas: akë njeri, akë punë, akë ç’ njeri, akë ç’ punë*; dh) përemëri **jatërë** a **t’jatërë**; e) përemëri **vetë** i cili përdoret i papërkthyerë, si: *ay vetë, ky vetë, unë vetë, ju vetë, erdhi vetë, vanë vetë; vetë vetiu, vetë vetëhesë, vetë vetëhenë, vetë vetëhet*; ë) përemëri **vetëhe** kur nuk përdoret si emërë: *me vetëhe, vetë vetëhe*; f) Fjala **gjë, gjësant, gjesendi, gjëkafshë** (A.O. - përdoren) të papërkthyerë (f. 79- 80). Përemrat e grupit (a) janë të vetmit që tregojnë *qysh* dhe gramatika e sotme i klasifikon si përemra dëftorë dhe jo si të pacaktuar. Përemrat e grupit (b, c, d, dh, f) janë përemra të pacaktuar sipas gramatikës së gjuhës shqipe sot, por që nuk tregojnë *qysh*. Përemrat e grupit (e, ë) janë përemra vetvetorë sipas gramatikës së gjuhës shqipe sot dhe nuk tregojnë *qysh*.

Përemëratë ndamës që tregojnë **sa** janë: a) Fjala **një** kur s’tregon nëmurë për njëjësit mashkullë a femërë: *një njeri, një punë*; dhe fjala **ca** për shumësit dhe për njëjësit asjatërë: *ca njerës, ca punëra, ca ujë*; b) *nonjë, ndonjë, noca, ndoca*; c) *asnjë, asnonjë, asndonjë*; ç) *disa*; d) fjala **aqë** për të treguarë së largu, edhe **kaqë** për të treguarë së afëri, janë përemra kur ndodhenë

përpara emërash: *aqë njërës, kaqë ujë*; kur ndodhenë përpara miemërash janë pasfolje: *aqë i mirë, kaqë i madh*; dh) fjala *tërë* e cila merr nyjetë: *i tërë, e tërë, të tërë, të tëra*; e) fjala *gjithë*: *gjithë katundi, gjithë shtëpia*; ë) përemëratë *kush* edhe *cilë* të pjekura me fjalën *gjithë*: *gjithëkush, gjithëcili, gjithëcila*; f) fjalëtë *shumë* e *pak* para emërave: *shumë botë, pakë njerës*; kur përdoren vetëm marrënjë nyje edhe përkthehenë: *i shumë, i shumi, e shumë, e shuma, të shumë, të shumë të, të shuma, të shumë të; i pakë, i paku*. (f. 80-82). Të gjithë **përemrat ndamës** që tregojnë **sa** janë përemra të pacaktuar në gramatikën e gjuhës shqipe sot dhe këtu Samiu ka treguar njohuri të sakta gjuhësore, njohuri që edhe sot qëndrojnë. Janë me interes shkencor konstatimet e Samiut për veçoritë e fjalëve si përemra dhe ndajfolje në grupet (d, f).

TRAJTA E SHKURTËR. Në gramatikën e gjuhës shqipe sot përdorim termin “**trajtë**” në këta togfjalështa terminologjikë: a) si kategori e emrave: “trajtë e shquar, trajtë e pashquar” dhe b) për format e shkurtuara të përemrave vetorë: “trajtë e shkurtër, trajtë e shkurtër e bashkuar”. Termi “trajtë” është sinonim me termin “formë” dhe kur themi “trajta e fjalëve” dhe “forma e fjalëve” kemi thënë të njëjtën gjë. Nisur nga sinonimia e dy fjalëve, Samiu përdor termin “**forma e çquarë**” për trajtën e shquar të emrave dhe **forma e paçquarë** për trajtën e pashquar të emrave.

Ndërsa për “trajtën e shkurtër” të përemrit vetor Samiu pagëzon termin **fytyrë** dhe konstaton saktë se *dhënëtorja dhe kallzonjëtorja kanë nga dy fytyre; fytyrë e shkurtuarë përdoren me foljetë: më tha, të tha* (f. 64). Samiu dallon **fytyrën** e plotë dhe **fytyrën e shkurtuarë** të përemrit vetor. Në tërësinë e kuptimeve fjala “fytyrë” ka kuptimin “pamje”, “dukje”; fjala “formë” ka kuptimin “dukje”, trajtë”; fjala “trajtë” ka kuptimin “formë”, “pamje”. Termi samian **fytyrë** është sinonim me termat e gramatikës sot “formë”, “trajtë”. Mendojmë se të tre termat mund të përdoren, duke i specializuar në përdorje: “forma e fjalëve”, “trajta e shquar ose e pashquar e emrit”, “fytyra e plotë ose e shkurtuar (ose e shkurtër) e përemrit vetor”.

FOLJA. “Folja është një fjalë që tregon një farë bërje a qënje, si: *tha, punon, venë, jam*. Folja ka nëntë farë ndarjesh: *veta, nëmëri, mëndyra, moti, shënimi, përkthimi, të rregullta - të parregullta, të pavetta, rrënjë e shtonjë. ... Folja ka tri vetë si edhe përemëri: e parë, e dytë, e tretë; folja ka dy nëmure si edhe emëri: njëjës, shumës* (f. 83-85). “Folja” si term është *kalkim etimologjik nga greqishtja rēma, latinisht verbum (= fjalë, të folur)* (Riza, 2009, f. 414). S. Riza e quan të **thukët** përkufizimin e Samiut, në krahasim me atë të Xhuvanit; vlerëson “një farë bërje” në krahasim me Xhuvanin “një punë” (Riza, 2009, f. 404).

Samiu quan **folja e paçquame** ose **e paçqueme e foljes** (f. 86) formën përfaqësuese të foljes në fjalor, formë që në gjuhët e tjera është “paskajorja”: p.sh., angl. “to be”, “to see”. S. Riza shkruan se “Samiu pa asnjë rezervë njohu egzistencën në shqipe të një paskajoreje **jo-perifrastike** (...) Përmëtepër, paskajoren **jo-perifrastike** “të motit të tanishim” ai (vërte jo pa u ndikuar nga gjermanishtja dhe frëngjishtja, por prapëseprap me një guxim prej shkencëtari) e mori si trajtë pikërisht themelore të mbarë sistemit foljor (Riza, 2009, f. 406). Samiu mendon se i shmanget sinonimisë me toskizmin **e paçquarë** (si kategori e emrit) dhe me gegizmin **e paçquame** (si trajtë themelore të foljes), trajtë, të cilën gramatika e gjuhës shqipes sot e emërton me termin “paskajore” (= “pa skaj, pa fund, pa anë” nga “i paskaj, i pafund, i pasosur”), kalkim ky nga gjuhët riolatine; fr. *infinitive*, angl. *infinitive*, it. *infinitive*.

Termi samian **e paçquame** është sinonim me fjalën ruse *neopredellënëj* “i pacaktuar, i paçquar”, fjalë, e cila është pjesë e termit në rusisht për paskajoren *neopredellënaja forma gllagólla* (“formë foljore e pashquar” ose “mënyra paskajore”, “infinitive”). Fjala **e paçquarë** dhe **e paçquame** veç një dallimi dialektor në fonetikë, nuk ka dallim tjetër, por, po t’i referohemi sistemit terminologjik samian **emër i paçquarë, folje e paçquame**, do të kemi dy terma për të shënuar trajtat përfaqësuese të emrit dhe të foljes, ashtu siç përfaqësohet fjala në një fjalor me trajtën e saj përfaqësuese.

ZGJEDHIMI. “Foljet përkthehenë pas pesë postatëve, të cilët thuhën përkthime” (f. 85). Samiu pagëzon “zgjedhimin” me termin **përkthimi** (zgjedhimi i foljeve). Me fjalën **postate** Samiu quan pasqyrat ose grupet e zgjedhimit të foljeve. S. Frashëri i klasifikon foljet në zgjedhime duke u nisur nga ajo trajtë që ne e emërtojmë sot me termin “paskajore”. **Postatet e përkthenjëvet** (pasqyrat e zgjedhimit ose grupet e zgjedhimit) Samiu i klasifikon në 5 grupe zgjedhimi të foljeve (f. 142). Me terminologjinë e gramatikës sot themi: “emrat ndahen në lakime; emrat lakohen ose lakoje emrin”; me terminologjinë e *Shkronjëtorë*-s së Samiut themi: emrat ndahen në **përkthesa**; emrat **përkthehen** ose **përkthej** emrin”. Në përdorimin e terminologjisë gjuhësore është e rëndësishme që të dallojmë “lakimi i një emri” dhe “zgjedhimi i një foljeje”.

Emrat klasifikohen në lakime, foljet klasifikohen në zgjedhime. “Me termin “zgjedhim” (kalkuar nga latinishtja “conjugatio”) Xhuvani kontribuoi pozitivisht në raport me Samiun, i cili krijoi termat **përkthim**, **përkthesë**, **përkthenie** të së njëjtës bazë leksikore **përkthyerë**” (Riza, 2009, f. 414). Në të vërtetë, Samiu është treguar i kujdesshëm, kur ka përdorur termin **përkthesë** për “lakimin” (deklinacioni), ndërtuar me një emër që ka kuptimin e rezultatit të veprimit (përkthesë), dhe **përkthenja** ose **përkthimi** për “zgjedhimin” (conjugation), ndërtuar me një emër që ka kuptimin e veprimit (përkthimi). “Foljet përkthehenë pas pesë postatëve, të cilët thuhën përkthime (f. 85). Me termin foljor **përkthej** Samiu kupton veprimin gramatikor në gjuhësi “lakoje emrin” dhe “zgjedhoj foljen”.

DIATEZA. Samiu për konceptin “diatezë” pagëzon si term fjalën **shënimi**, për të cilin S. Riza shkruan se “termi i Samiut në domethënien **shqim**, **dallim** qëndron tepër larg nga ideja e **llojit foljor apo diatezës së foljes** (Riza, 2009, f. 414). Dhe më poshtë: “Simbas gramatikës tradicionale, diateza e foljevet ka të bëjë vetëm me pyetjen nëse trajta e foljes tregon një proces të prodhuar prej kryefjalës së fjalisë (folje veprorë), apo përkundrazi të pësuar prej kësaj kryefjale (folje pësore) apo njëherazi të prodhuar dhe të pësuar prej së njëjtës kryefjale (foljet vetëvehtjore) (Riza, 2009, f. 434). Në gjuhën ruse fjala “zallog” si term ka kuptimin “diatezë” në gramatikë, por edhe kuptimin figurativ “shenjë” dhe ky kuptim është pranë kuptimit të fjalës **shënim** që Samiu e pagëzon term në gramatikë.

FOLJET KALIMTARE DHE JOKALIMTARE. Në *Shkronjëtorë*-n e Samiut ndeshim konstatimin se folja ka dy **shënime: ngasës** (për foljet kalimtare) dhe **mosngasës** (për foljet jokalmimtare). Termi **shënim** në *Shkronjëtorë*... tregon: a) nëse foljet janë **kalimtare** apo **jokalmimtare** (dhe me këtë kuptim ky term përdoret në vend të termit “reksion i foljes ose drejtimi” që ekziston dhe përdoret në terminologjinë e gramatikës së gjuhës shqipe sot); b) nëse foljet janë **veprorë** apo **joveprorë** (dhe me këtë kuptim në gramatikën e gjuhës shqipe sot përdorim termin *diatezë*.) Në gramatikën e gjuhës shqipe sot përcaktohen si kalimtare ose jo kalimtare ato folje që kanë mundësi ose nuk kanë mundësi të marrin një kundrinor të drejtë në fjali.

Gjuhëtarët terminologë sot mund ta marrin në shqyrtim termin **shënimi** të Samiut për ta përdorur me kuptimin e termave të sotëm “të llojit foljor ose të reksionit të foljes” - “folje kalimtare” ose “jokalmimtare”. Me togfjalëshin terminologjik **shënimi ngasës** Samiu pagëzon foljen kalimtare, atë folje “me të cilën ngasim një njeri a një gjë: shoh, vras, ha” (f. 84). Me togfjalëshin terminologjik **shënimi mosngasës** Samiu pagëzon foljen jokalmimtare, atë folje, “me të cilën s’ngasim gjë: fle, vdes” (f. 84). Termat samianë **ngasës**, **mosngasës** mendojmë se janë të lidhur me termin “drejtim”, që në gramatografinë tradicionale evropiane lidhet me termin “reksion”. S. Riza shkruan se “simbas gramatikës tradicionale, reksioni i foljevet ka të bëjë vetëm me pyetjen se ç’lloj plotësish mund të marrin foljet, të cilat prej kësaj pikëpamjeje dallohen në **intransitive** (që mund të marrin vetëm plotës rrethnorë) dhe në **transitive** (të cilat, përveç plotësve rrethnorë, mund të marrin edhe plotës kundrinorë”. (Riza, Tiranë, 2009, f. 433-434).

Folja “ngas” në gjuhën e popullit, përveç kuptimeve të tjera, ka edhe kuptimin “drejtoj”, “vozis”. Mendojmë se për termat **ngasës**, **mosngasë** Samiu ka kalkuar termin e huaj “reaksion” (= drejtim), dhe jo termin “tranzitiv” me kuptimin “kalimtar”, që përdorin gjuhët evropiane për këtë koncept. Mendojmë se Samiu e ka ditur termin “tranzitiv” dhe se nuk i ka munguar fjalorit të tij as fjala shqipe “kalimtar”.

Samiu dallon katër diatezat e foljes në gjuhën shqipe: diatezën **pësonjëtores** (*goditemë, vritemë, pyetemë*; **vetëvetores** (*lahemë* (lanj vetë vetëhenë), *ruhemë* (ruaj vetë vetëhenë); **mesëtores** (*qahemë, përtypsemë*). “Diatezën veprorë” e pagëzon **punëtores** (*godit, vras, pyes* (f. 85). “Veprorja” e Xhuvanit shënon një përparim kundrejt “punëtores” së Samiut. (Riza, Tiranë, 2009, f. 414). Mendojmë se Samiu e pagëzon “diatezën veprorë” me termin **punëtores**, ngaqë përkon me përkthimin e fjalës nga fr. *actif* (= punëtor), it. *attivo* (= punëtor).

PJESËZA GRAMATIKORE. Samiu quan **shkronjë u** atë që në gramatikë është “pjesëza **u**” e trajtave joveprorë. S. Riza shkruan se “pjesëza **u** e diatezës jo-veprorë përbën një të dhënë gjuhësore që egziston pavarësisht nga shenja e shkrimit e që bart një kuptim; prandaj ajo nuk ishte për t’u quajtur “**shkronjë**” as madje “**zë**” (Riza, Tiranë, 2009, f. 413). Samiu i njeh “pjesëzat” me termin **thërria**, kurse “pjesëzën **u**”, edhe pse e dallon për nga funksioni gramatikor dhe si të dhënë gjuhësore, e quan **shkronjë**, term që sot emërton trajtat shkrimore të tingujve.

MËNYRA. Folja, sipas Samiut, ka shtatë mënyra, kurse ndonjë përkufizim për kategorinë e mënyrës së foljes autori nuk formulon. Dhe S. Riza flet për 7 mënyrët foljore (vehtjore). “Mënyrën dëftore” Samiu e pagëzon me termin **mëndyra e preme** (f. 83). Në gr. *oristikí* (mënyra dëftore) ka dhe këto kuptime: “definitiv, përfundimtar, e prerë, e skajuar, e shquar”. Në shqipe fjala “i, e prerë” ka dhe kuptimin “i, e padiskutueshëm”. Në këtë pagëzim terminologjik Samiu mund të ketë mbajtur parasysh kuptimin themelor të mënyrës dëftore të foljes, kuptimin e vërtetësisë, modalitetin e vërtetësisë, ekzistencën e fenomenit të shprehur nga folja si të vërtetë. Dhe ndajfolja “prerë” ka kuptimin “hapur, qartë, drejtpërdrejt”. S. Riza është në të mirë të termit të Samiut, përkundër termit “mënyrë dëftore” të A. Xhuvanit. (Riza, Tiranë, 2009, f. 414).

Mënyrën dëshirore Samiu e pagëzon **mëndyra e uruame** (*vafsh, paça vajturë*) (f. 83). Folja në mënyrën dëshirore shpreh dëshirë në formën e mallkimit apo të urimit; folja “uroj” është sinonime me “dua, dëshiroj”. Termi samian nuk ka dallim kuptimor nga termi që përdorin gramatikët sot. Termin **mëndyra e varme** (lidhore) të *vete, të vinja* (f. 83) Samiu do ta ketë kalkuar nga gr. *ipotaktikí* (që në këtë gjuhë ka kuptimin “urdhërore”) e ky term samian është më pranë kuptimit të kësaj mënyre sesa termi “mënyra lidhore”, sepse “në asnjë gramatografi mënyra në shqyrtim nuk cilësohet me cilësorin e “përemrit **lidhor**”, sepse dy specifikat të kësaj mënyre dhe të këtij përemri larg së qeni identike nuk janë as analoge. Prandaj dhe Samiu, kundrejt terminit: “përemër **përmendës**”, ka krijuar terminin “mëndyrë **e varme**”. (...) Folja që vihet në këtë mënyrë - më sëforti i takon një fjalie pikërisht të **mvarur**, e për pasojë të **nënërenditur** a **nënrenduar** ndaj fjalisë kryesore”. (Riza, Tiranë, 2009, f. 505).

Në gramatografinë evropiane “përemri lidhor” ka si cilësor termat fr. “*relatif*”, angl. “*relative*”, gjerm. “*relativpronomen*”, it. “*relativo*” me kuptimin “lidhje”, ndërsa “mënyra lidhore” ka si cilësor termat fr. “*subjonctif*”, angl. “*subjunctive*”, gjerm. “*subjunktiv*”, it. “*soggiuntivo*” me kuptimin “nën-lidhje, nënvarje” me parashtesën “*sub-*” që do të thotë “nën-”. Duke u nisur nga kjo analizë tërheqim vëmendjen tek rekomandimi i S. Rizës që mënyra **lidhore** të ripagëzohet “**nënrendore**”. Po kështu, nisur nga kjo analizë, S. Riza shkruan se “...termini i Xhuvanit “mënyrë lidhore”, bashkëegzistues me terminin po të Xhuvanit “përemra lidhorë”, është për t’u kritikuar në krahasim me terminin e Samiut “mëndyrë **e varme**”. (Riza, 2009, f. 414). **Mëndyra e urdhuame** (urdhërore) *hiq, bëj* është trashëguar në gramatikën shqipe sot (f. 83).

Gramatika shqipe sot quan “forma të pashtjelluara të foljes”: “pjesoren”, “përcjelloren”, “formën e pashtjelluar mohore”, “format e pashtjelluara të tipit *për të larë, me të larë*”. Në *Shkronjëtores*-n e Samiut këto forma quhen **mëndyra: mëndyra e përcjellme** (përcjellore) *duke vajturë, duke pasurë vajturë* (f. 83); **mëndyra e paçqueme** (paskajore) *vajturë, ardhurë* (f. 83); **mëndyra përgjysmore** (pjesore) *i ardhurë, i vaturë* (f. 83). Ai përdor tre variante termash për konceptin “pjesore”: **përgjysmoretë** (f. 57), **përgjysmësi** (f. 83) dhe **pjesëtoresetë**. Sami Frashëri shkruan se “*përgjysmësi s’është folje, por është një miemërë i bërë prej foljeje, p’andaj edhe zihetë një farë fjalë më vetëhe*” (f. 98). Më poshtë ai shkruan: “.... *përgjysmësi ...bëhetë prej foljeje edhe ruan shënimn’ e foljesë, po përdoret si miemërë. përgjysmësi merr nyje si miemëri, edhe bëhetë mashkullë, femërë, asjatërë, njëjës e shumës*” (f. 167).

S. Riza shkruan: “*Termet samianë përgjysmoretë, përgjysmësi, që për nga kuptimi janë të njëjta, shpjegojnë natyrën e dyfishtë të këtyre formave foljore, që ngjajën me foljen dhe me mbiemrin. Termin variant pjesëtore (që solli atë të Xhuvanit pjesore) Samiu do ta ketë kalkuar nga ai i latinishtes participium = pjesëmarrës*” (Riza, 2009, f. 414). Termi “participium = pjesëmarrës” nënkupton natyrën sintaktike edhe nominale adjektivale, edhe foljore të pjesores. “*Së këndejmi shihet sa i papërpiktë është termini pjesore i Xhuvanit dhe pjesëtore i Samiut. Ndërkaq na edhe dy terminevet tjerë të Samiut: përgjysmore, përgjysmës do t’u parapëlqenim kalkun veltjak pjesëmarrjore*” (Riza, 2009, f. 518-519).

Nuk përjashtohet mundësia që termi samian **pjesëtore** të jetë klkuar dhe nga greqishtja “*metohi*” që ka të njëjtin kuptim: “pjesëmarrës”. Sipas S. Rizës “*për pjesore të shqipes Samiu njohu vetëm pjesoren e adjektivuar vetëm të diatezës veprorë*” (Riza, 2009, f. 407). “*Pra Samiu mori në një anë pjesoren si paskajore, e n’anë tjetër pjesoren e adjektivuar si pjesore patjetër*” (Riza, 2009, f.407). Samiu ka dalluar trajtën **e paçquarë** të emrit si trajtë përfaqësuese, po ashtu dallon dhe trajtën **e paçquemja** (fr. *infinitif*, gr. *áparémfatos*, “paskajorja”) të foljes si trajtë përfaqësuese të foljes (f. 98) dhe për këtë term u shprehëm në rreshtat për **foljen e paçquame**.

KOHA. Në vend të termit “koha” të gramatikës shqipe sot, Samiu përdor termin vetjak **moti** (f. 83), që është sinonim me fjalën “kohë” (*FSGJSH*, 2007). Fjala it. *tempo* ka gjithashtu kuptimin “kohë, mot” (*FISH*, 1939). Nga këto dy referime mësojmë se në fillimshkullin XX fjalët “kohë” dhe “mot” përdorëshin me të njëjtin kuptim dhe në vend të njëri-tjetrit. Dhe termi gjerm. *Zeitform* ka në përbërje fjalën “zeit” (= kohë). Termi angl. *tense* ka kuptimin “forma e zgjedhueshme e një foljeje që tregon kohën e veprimit ose të gjendjes së saj” (*RHD*, 1978). Termi *tense* është më specifik ose më i specializuar për termin gramatikor “kohë e foljes”.

Dhe termi rus. *vremja* ka kuptimin “kohë”. Me përjashtim të termit në anglisht, termi në shqipe, rusisht, italisht, frëngjisht ka edhe kuptimin e kohës si “gjendje e atmosferës” (*FTHFSH*, 1972): kohë e bukur, e keqe, e ngrohtë, e ftohtë etj. Në *FGJSSH*, 1980 për fjalën “mot” dhe fjalën “kohë” gjejmë kuptimet si për periudhën kohore, ashtu dhe për gjendjen e atmosferës. Mendojmë se Samiu ka përzgjedhur si më të përshtatshme për termin e tij fjalën “mot” për të shënuar konceptin e kohës së veprimit. Gjithashtu fjala “mot” shpreh një nocion kohor më të spikatur, pasi lidhet kuptimisht dhe me fjalën “vit” si periudhë kohore. Samiu mund ta ketë pagëzuar si term fjalën “mot” me kalkimin e drejtpërdrejtë nga gr. *hronos* që do të thotë “kohë”, “vit”.

Samiu i klasifikon kohët e foljeve me termat **moti i thjeshtë, moti i përzjer, moti i mëdyshmë**. Për termin samian **moti i thjeshtë**, gjendet në *FTGJ*, 1975 termi “kohë të thjeshta”; në disa gramatika gjejmë termin “kohët e thjeshta të foljeve”, në *FGGJSLSH*, II, 1976 për këto kohë përdoret termi “forma gramatikore sintetike” të foljes (f. 10), kurse S. Riza ndërton termin “format e thjeshta foljore” që dallohen sipas raportit të kohorësisë (Riza, 2009, f. 551). Për termin samian **moti i përzjer**, gjendet në *FTGJ*, 1975 termi “kohë të përbëra”; në disa gramatika gjejmë termin “kohët e përbëra të foljeve”, në *FGGJSLSH*, II, 1976 për këto kohë përdoret termi “forma

gramatikore analitike” të foljes (f. 10), kurse S. Riza ndërton termin “format e përbëra foljore ose format e pathjeshta foljore” (Riza, 2009, f. 551). Për **motet e përzjera** Samiu shkruan se “*motet e përzjerë bëhenë prej mëndyravet e motet e foljesë pasurë a qënë edhe prej së paçquemes’ së foljesë*” (f. 86). E kemi trajtuar më lart se S. Frashëri përdor termin **e paçqueme** për atë formë të pashtjelluar të foljes, që gramatika e sotme e quan “pjesore”. Për termin samian **moti i mëdyshmë**, gjendet në *FTGJ*, 1975 termi “kohë e mbipërbërë”; në *FGGJSLSH*, II, 1976 gjejmë të shprehur termin “forma e mbipërbërë” për të kryerën e tipit (*kam pasë larë*) dhe për më se të kryerën e tipit (*kisha pasë larë*), (f. 247), kurse S. Riza ndërton termin “format e tejpathjeshta foljore” (Riza, 2009, f. 551).

Për **motet e mëdyshme** Samiu shkruan: “*Përdoren’ edhe ca mote të përzjerë dy herë, domethënë me të shtuarë edhe një të paçquame nëpër gjithë motet e përzjerë: i parëtanishim i mëdyshmë: kam pasurë pasurë, kam pasurë qënë; kisha pasurë pasurë, kisha pasurë qënë*” (f. 99). Termi samian **mot i mëdyshmë** mund të jetë kalkuar nga gjerm. *doppelt* (= i dyfishtë) dhe lidhet kuptimisht me përdorimin e dyfishtë ose të përsëritur të **së paçqumes**. Në sistemin foljor Samiu dallon **folje ndihmëse pasurë, qenë** (f. 86) me të cilat ai përshkruan ndërtimin e formave të përbëra kohore të foljeve.

Termtat përcaktues për kohët e foljeve në *Shkronjëto*-n e Samiut nuk ndryshojnë shumë nga termtat që përdor gramatika shqipe sot. Ja disa prej termave të kohëve të foljes që ndërton Samiu, krahasuar me termtat që përdor gramatika shqipe sot:

<i>termtat nga Samiu</i>	<i>termtat nga gramatika shqipe sot</i>
moti i tanishim (f. 83)	koha e tashme
moti i parthim	koha e pakryer
moti i shkuarë (<i>vajta</i>)	koha e kryer e thjeshtë
moti i pritm’ i tanishim (<i>do të vete</i>)	koha e ardhme

<i>termtat nga Samiu</i>	<i>termtat nga gramatika shqipe sot</i>
moti i parëtanishim (<i>kam vajturë</i>) (f. 84)	koha e kryer
moti i mëparthim (<i>kisha vajturë</i>)	koha më se e kryer
moti i parëshkuarë (<i>paçë vajturë</i>)	koha e kryer e tejshkuar
moti i pritm’ i parëtanishim (<i>do të kem vajturë</i>)	koha e ardhme e përparme

Ndër termtat që pagëzon Samiu, bie në sy një përpjekje e tij e ndërgjegjshme për të krijuar një sistem terminologjik pa të meta dhe të sistematizuar; nga njëra anë gjejmë termin **moti i tanishim** për formën e thjeshtë foljore dhe përballë këtij termi gjendet termi **moti i parëtanishim** për formën e përbërë foljore. Me këtë rregull fjalëformues dhe termformues gjejmë termtat e ndërtuar nga Samiu për sistemin kohor të foljeve në mënyrën dëftore: **moti i parthim - moti i mëparthim; moti i shkuarë - moti i parëshkuarë; moti i pritm’ i tanishim - moti i pritm’ i parëtanishim**.

Një sistem terminologjik i tëri shqip. Nuk janë të pakta rastet në gjuhën shqipe që, për të dhënë dhe për të shtënë në përdorim kuptimet e reja të fjalëve, gjuhëtarët modifikojnë në mënyrë të ndërgjegjshme format e fjalëve: *nyjë-nyja, nyje -nyje, gjaqe-gjakëra, rrathë-rrethe, gjinj-gjire* etj. Mendojmë se kështu ka vepruar dhe Samiu për të ngritur një terminologji shqipe të gramatikës shqipe nga hiçi. Ai pagëzon si terma fjalët që i fjalëformon me kurajë dhe logjikë shkencore.

Termat që përmbushin këto karakteristika, sipas mendimit tonë, janë **i parëtanishim**, **i parëshkuarë**. Për termat **i parëtanishim**, **i parëshkuarë** Samiu do të ketë marrë si model fjalëformues fjalët që gjuha shqipe i ka në gjirin e saj, ndërtuar sipas skemës (parashtesë ndajfoljore *para-* + mbiemër). Termi **i parëtanishim** për nga modeli fjalëformues është i ngjashëm me fjalët “i parëmbërshëm”, “i parëdjeshëm”. Ndërsa modeli fjalëformues i tipit (parashtesë ndajfoljore *para-* + *mbiemër* foljor) është i zakonshëm në gjuhën shqipe dhe Samiu ndërton me këtë model termin **i parëshkuarë**. Për kohën e ardhme Samiu pagëzon si term fjalën shqipe **i pritme**, sinonime për nga kuptimi me fjalën “i ardhshëm” (*FSHS*, 1984, *FSGJSH*, 2007).

Samiu dallon dhe formën foljore **moti i pritme i përzier** (tosk. *kam për të pasurë*, geg. *kam me pasunë* a *kam me pas*; kisha për të pasurë, kisha me pasunë a kisha me pas) (f. 100), e cila emërtohet me termin “koha e ardhme e tipit *kam për të bërë*” në *FGGJSLSH* II, 1976 (f. 272). Në mënyrën dëftore Samiu ka futur dhe format foljore të mënyrës kushtore dhe të mënyrës habitore, ngaqë ato, shkruan S. Riza, “janë të një strukture paralele me të ardhshëmen dhe së parardhshëmen të dëftores. Prandaj në dy palë trajtat e kushtores Samiu vështroi t’ardhshëmen e pakryeme dhe t’ardhshëmen e parpakryeme të dëftores” (Riza, 2009, f. 503).

Një arsye tjetër që Samiu ka përfshirë brenda mënyrës dëftore edhe format foljore të mënyrës habitores bashkë me ato të mënyrës kushtore, mund të jetë dhe fakti se “*habitorja, kushtorja mohohen me pjesëzën nuk të dëftores, (kurse 4 mënyrat vehtjore jodëftore mohohen me pjesëzën mos). Për këto arsye habitorja dhe kushtorja përbëjnë një si hallkë lidhjeje të dëftores me 4 tjerat mënyrë vehtjore jo-dëftore: lidhorja, dëshirorja, lidhore-habitorja, urdhërorja*” (Riza, 2009, f. 513). Samiu nuk e klasifikon mënyrën habitore të gjuhës shqipe si mënyrë më vete, por, sipas nesh, formën habitore të foljes ai e vë re dhe e pagëzon “mënyrën habitore” me termin **i papandehur**. Siç e vumë në dukje më lart, Samiu i përfshin format e habitores të kohët e mënyrës dëftore: *vajtëkam* (f. 83).

Gjithashtu, Samiu përcakton drejt katër format kohore të foljes në mënyrën habitore, por ndërtimi i termit **moti i papandehur** (= kohë habitore !?) duket i pakuptimtë. Sikur në vend të fjalës **mot** Samiu të kishte përdorur saktë fjalën **mëndyrë**, termat nuk do të kishin të sharë; prandaj termat me këtë ndërtim tingëllojnë çuditshëm: **moti i papandehur i tanishim** (për habitore e tanishme *vajtëkam*, f. 83); **moti i papandehur i parthim** (për e pakryera e habitores: *vajtkështa*, (f. 84); **moti i papandehur’ i parëtanishim** (për e kryer e habitores: *paskam vajturë*, f. 84); **moti i papandehur’ i mëparthim** (për më se e kryer e habitores: *paskëshim vajturë*, f. 84).

moti i papandehur i tanishim	habitore e tanishme: <i>vajtëkam</i>
moti i papandehur i parthim	e pakryera e habitores <i>vajtkështa</i>
moti i papandehur’ i parëtanishim	e kryer e habitores: <i>paskam vajturë</i>
moti i papandehur’ i mëparthim	më se e kryer e habitores: <i>paskëshim vajturë</i>

Fjala “i papandehur” është sinonime me fjalët “i papritur”, “i befasishëm” (*FSGJSH*, 2007). Nga *FSGJSH*, 2007, kemi shkëputur vargjet sinonimike, me qëllim që të zbulojmë lidhjen e termit samian **i papandehur** me termin e gramatikës së gjuhës shqipe sot “mënyra habitore”:

i papandehur (= i papritur, i befasishëm);

i papritur (= i habitshëm, i befasishëm, i papandehur);

i habitshëm (= i çuditshëm),

Përmes këtyre vargjeve sinonimike zbulojmë sinoniminë e termave **i papandehur** (= i habitshëm) dhe prej këndej duhet të rrjedhë termi i gramatikës shqipe sot “mënyra habitore”. Në gramatikat e huaja për mënyrën habitore gjejmë të njëjtën fjalë-term: termin “admirativ” në rusisht, anglisht, gjermanisht dhe në italisht. Kuptimi i fjalës “admirativ” është “i çuditshëm”, sinonim me “i habitshëm”, dhe do të ketë mjaftuar kuptimi sinonimik i fjalëve për të pagëzuar si term në gramatikën e gjuhës shqipe sot fjalën “habitore”.

Më lart zëmë në gojë se Samiu përfshin në mënyrën dëftore dhe format foljore të asaj mënyre që në gramatikën e shqipes sot e emërtojmë “mënyra kushtore”. Samiu dallon **moti i pritm’ i parthim** në vend të kohës së tashme të kushtores në gramatikën shqipe sot: *do të vinja*, (f. 84). S. Riza e quan absurd termin **moti i pritm’ i parthim** (Riza, 2009, f. 406). Samiu dallon **moti i pritm’ i mëparthim** në vend të kohës së kryer të kushtores në gramatikën shqipe sot: *do të kisha vajturë, do të kisha thënë*, (f. 84). Po t’i referohemi gramatikës shqipe sot, termi i Samiut **moti i pritm’ i parthim** mbulon fjalë për fjalë konceptin dhe termin “koha e ardhme e së shkuarës”; termi i Samiut **moti i pritm’ i mëparthim** mbulon fjalë për fjalë konceptin dhe termin “koha e ardhme e përparme e së shkuarës” në morfologjinë shqipe sot.

Samiu dallon **moti i pritm’ i papandehurë**, e cila është një kohë që s’përdoret në gramatikat e sotme dhe ka kuptimin e “së tashmes kushtore” dhe është ndërtuar mbi bazën e lidhore-habitores së pakryer *do të vajtkësja, do të thënkësja*, (f. 84). Samiu dallon **moti i pritm’ i parëpapandehurë**, formë që s’përdoret në gramatikat e sotme, me vlerën e një “të kryere të kushtores”, e cila është formuar mbi bazën e më se të kryerës së mënyrës lidhore-habitores, që takohet rrallë në disa të folme të jugut: *do të paskësja vajturë, do të paskësja thënë* (f. 84).

moti i i pritm’ i parthim (<i>do të vinja</i>)	e tashme kushtore
moti i pritm’ i mëparthim (<i>do të kisha vajturë</i>)	e kryera e kushtores
moti i pritm’ i papandehurë (<i>do të vajtkësja</i>)	e tashme e kushtores mbi bazën e lidhore-habitores
moti i pritm’ i parëpapandehurë (<i>do të paskësja vajturë</i>)	e kryera e kushtores mbi bazën e lidhore-habitores

Termi **moti i pritm’ i parëpapandehurë** është i pakuptimtë sidomos terminoelementi **i parëpapandehurë**, që po ta shprehim me termin e gramatikës shqipe sot do të ishte “koha e parëhabitore!?”.

FOLJET E RREGULLTA DHE FOLJET E PARREGULLTA. Në punën e tij prej gramatikani Samiu nuk lë pa klasifikuar dy grupet e foljeve: **folje të rregullta**: “*thuhënë foljet që përkthehenë pas një përkthimi me rregullë të përgjithçime*”; **folje të parregullta**: “*thuhënë foljet të cilave ca e gjithë mëndyrat’ e motet u përkthehenë jashtë rregullësë a me një rregullë më vetëhe: ardhurë, bërë, bërthiturë, blerë, çapurë, dalë, dashurë*” (f. 85). Samiu klasifikon **të pavetta** (pavetore) “*foljetë që spërkthehenë në gjithë vetat, si: gjëmon*” (f. 85). Samiu i ka përkufizuar këto folje në mënyrë tepër lakonike dhe mjaft ngjashëm me përkufizimin që jep gramatika shqipe sot: foljet pavetore janë foljet që nuk kanë një kryefjalë të shprehur ose të nënkuptuar (*FGGJSLSH*, II, 1976, f. 228-229).

NDAJFOLJA. Samiu dallon **mifoljen, pasfoljen** dhe përkufizon: “*Mifoljeja është një fjalë e papërkthyerë me të cilënë mbarohetë shënim’ i një foljeje, i një miemëri a i një mifoljeje tjetër: mirë thua, më trim, fort trim; mifolja ndahet më shtatë*” (A.O. - lloje) (f. 168). Në këtë klasifikim të Samiut përfshihen dhe ato pjesë të ligjëratës, të cilat janë “pjesëza” në gramatikën shqipe sot.

LIDHËZAT. Samiu i pagëzon “lidhëzat” me termin **lidhjetë** dhe përkufizon: “*Lidhjeja është një fjalë e papërkthyerë e cila lidh fjalët në mes të tyre: e edhe, dhe (ende), a, o, apo, as, po, por se, të, që të, në (ndë), të, që se, kur si, pra, prapo pa, andaj, a’andaj; eni, ndonëse, posa, po qe, sado që, parë se sepse*” (170). Samiu dallon qartë kur e njëjta fjalë është lidhëz: *un’ e ti, vet’ e vjen*; dhe kur po ajo fjalë është nyjë: *deg’ e lisit*.

PJESËZA. Samiu i pagëzon “pjesëzat” me termin **thëria** (*s’, nukë, mos*) (f. 144). Ai shkruan: “*Prapsja (A.O. - mohimi) tregon mos qënjen’ a mos bërenj’ e punës që rrëfen folja dhe bëhet me të sjellë përpara foljesë thërijënë s’ a nukë, mos*” (f. 151). Termi **thëria** shënon një përparim shkencor në raport me përcaktimin e kësaj pjese të pandryshueshme të ligjëratës dhe vë në dyshim termin **mifolje prapsëtoare** që përfshin pjesëzat e klasifikuara josaktësisht në këtë grup.

PASTHIRRMA. Samiu i pagëzon “pasthirrmat” me termin **thirrjetë**. Ai përkufizon: “*Thirrjeja është një fjalë e papërkthyerë a një zë që rrëfen gas, helmë, çudi etj.: or! ore! oj! mor! more! moj! mori! oh! ah! of! oji! pupu! popo! bobo! ë! ëh! hë! haha! oh! ohoho! na!, oj! pyh! hop! hopa! fët! fiu! frap! hesht! shët! tyt! haj! ysh! deh! pësh! oha! pty! cap! etj.*” (f. 171). “Thirrje” dhe “thirrme” janë dy fjalë që kuptohen lehtë nga folësit e gjuhës shqipe.

Termi “pasthirrmë” është kalkim nga greqishtja *epifonima*, dhe për mendimin tonë, termi samian **thirrjetë** është më pranë natyrës së gjuhës shqipe, sesa termi “pasthirrma”. Parafjala *pas-* ose ndajfolja *pas*, kur hyjnë në përbërje të fjalëve të përngjitura ose kur luajnë rolin e parashtesës në formimin e fjalëve të reja, formojnë njësi gjuhësore që kanë kuptimin “pas” në raport me vendin ose me kohën, p.sh., *pastheksor, pasthënie, pasardhës, paskrahu, pasnesër, pasdite* etj., kurse “pasthirrmë” nuk plotëson asnjë nga dy raportet e përmendura më lart. “Thirrje” ose më e saktë “thirrma” do të ishte termi më i përshtatshëm, sipas mendimit tonë.

SINTAKSA. Nga sintaksa Samiu sjell vetëm një të dhënë që lidhet me fjalinë pyetëse dhe me këtë degë të gjuhësisë ai nuk është marrë. Kuptimin e fjalisë pyetëse e jep kështu: “*Pyetja bëhet me të sjellë thërijënë a përpara foljesë: a vete? a dotë veç? edhe pa këtë thërijë me të dhënë zërit një forcë të ndryshme si: vate?, dotë veç?*” (f.151).

SHENJAT E PIKËSIMIT. Sami Frashëri në faqet e para të *Shkronjëtores*-s së tij jep disa të dhëna për shenjat e pikësimit dhe për përdorimin e tyre: “**pikatë** (...) tregojnë që ka edhe më për të thënë”; “**pika** (.) tregon një çlodhje të mjaftë me të marrë frymë mirë”; “**pikëpresja** (;) tregon një çlodhje më të madhe me të marrë frymë më tepërë”; “**dy pikatë** (:) tregojnë një gjë që vjen më poshtë”; “**presja** (,) tregon një çlodhje të vogëlë me të marrë pakë frymë”; “**pyetësi** (?) tregon pyetje”; “**çuditësi** (!) tregon çudi, gas, helm, tmer etj.” (f. 11).

Referencat

- [1]. ASHRSH. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. (1976) *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe, II*. Tiranë.
- [2]. DEMIRAJ, SH. (1986) *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë.
- [3]. DODI, A. (2004) *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- [4]. FRASHËRI, S. (1886) *Shkronjëtores e Gjuhës Shqip*. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Vepra 2, Tiranë, 1988, Vepra 5, LogosA, 2004, (botuar për herë të parë në Bukuresht në vitin 1886).
- [5]. RIZA, S. (2009) *Vepra të zgjedhura*. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë.
- [6]. ROBINS, R. H. (2007) *Historia e Gjuhësisë*. DITURIA.

Shkurtime

(për Fjalorët Gjuhësorë të përdorur në punim në rend alfabetik)

- [1]. **FASH, 1996** - FJALORI ANGLISHT-SHQIP, 1996
- [2]. **FGJSSH, 1980** - FJALOR I GJUHËS SË SOTME SHQIPE, 1980
- [3]. **FGJSH, 1978** - FJALOR GJERMANISHT-SHQIP, 1978
- [4]. **FISH, 1939** - FJALUER ITALISHT-SHQIP, Tiranë, 1939
- [5]. **FISH, 2010** - FJALOR ITALISHT-SHQIP, Tiranë, 2010
- [6]. **FKTGJ, 2011** - FJALOR KRAHASUES I TERMAVE TË GJUHËSISË, 2011
- [7]. **FRSH, 1954** - FJALOR RUSISHT-SHQIP, Moskë, 1954
- [8]. **FSGJSH, 2007** - FJALORI SINONIMIK I GJUHËS SHQIPE, Tiranë, 2007
- [9]. **FSHA, 2002** - FJALOR SHQIP E ANGLISHT, Tiranë, 2002
- [10]. **FSHS, 1984** - FJALORI I SHQIPES SË SOTME, Tiranë, 1984
- [11]. **FTGJ, 1975** - FJALOR I TERMAVE TË GJUHËSISË, 1975
- [12]. **FTHFSH, 1972** - FJALOR THEMELOR FRËNGJISHT-SHQIP, 1972
- [13]. **FGGJSLSH, II, 1976** - FONETIKA DHE GRAMATIKA E GJUHËS SË SOTME LETRARE SHQIPE, II, 1976
- [14]. **RHD, 1978** - THE RANDOM HOUSE DICTIONARY, New York, 1978